

# EC

MA NDRYSHE

# EKO SHKOLLA

- REDUKTO - RIPËRDOR - RIKIKLO -



## EKO KLUBI

## "LASGUSH PORADECI"

# 1




Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Zhvillimit Rajonal  
Ministarstvo za Regionalni Razvoj  
Ministry of Regional Development

## CARITAS

Schweiz  
Suisse  
Svizzera  
Svizra

## YENI

YOUTH  
ENVIRONMENTAL  
IMPACT



Të dashur lexues,

EC ka filluar publikimin e buletineve mjedisore të eko-klubeve të shkollave të mesme nga Rajoni i Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës). Ky është buletini i parë informativ, i cili do të përmbajë mesazhe, intervista, ese, punime fotografi dhe shkrime të ndryshme mbi mjedisin dhe ndryshimet klimatike dhe njoftime mbi punën që po zhvillohet në këto tema nga eko-klubi i IAAP "Lasgush Poradeci" dhe OJQ EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "ECO School".

Ky projekt do t'i njohë me konceptin "Eko Shkolla" 12 shkollat e rajonit të Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës), përmes pilotimit të formave dhe metodologjisë për mbrojtjen e mjedisit me pjesëmarrje të gjerë të nxënësve dhe mësimitdhënësve.

Në kuadër të projektit ofrohet një model dhe metodologji që përdoret gjerësisht në vendet e zhvilluara, e cila po zgjerohet me shpejtësi edhe në vendet në zhvillim. Përvojat botërore tregojnë se shkolla ekologjike është një fenomen në rritje, e cila nxit të rinjtë të angazhohen në mjedisin e tyre duke u dhënë atyre mundësinë për ta mbrojtur atë në mënyre aktive.

Projekti po ashtu do të kontribuojë në Strategjinë e Mjedisit dhe Planin e Veprimit në Mjedis të Kosovës, duke rekomanduar zhvillimin e programeve për edukimin mjedisor në të gjitha nivelet (shkolla dhe universitete).



# MJEDISI

-Mjedisi fjalë e bukur, por kur vie tek bukuria e mjedisit që na rrethon nuk mund të thuhet e njëjta gjë.

-Ndalem dhe mendoj, mendoj se pse të më interesoj mua apo dhe ty se e ndotim ambientin, se hedhim mbeturina? Pse të na interesoj ne se një mbeturinë, apo ndotje sado e vogël, mund të jetë shkaktar i shumë sëmundjeve që mund të keni ju, apo edhe dikush i dashur për ju? E vështirë apo jo!

Të dish që një gabim i juaj mund të lëndoj një jetë të pafajshme. Kemi bërë shumë dëme ndaj nënës natyrë, dëme, pasojat e të cilave nuk po prekin vetëm të fajshmit por edhe ata të cilët u munduan që njeriu të jetë në harmoni me natyrën. Jemi ne po ata të cilët kanë nevojë për natyrën. Atëherë më thuaj se pse jemi ne po ata të cilët dita ditës po e shkatërrojmë atë? Duke shkatërruar natyrën po shkatërrojmë edhe veten, gjë që njerëzimi e ka të vështirë për ta kuptuar. Ndotja mjedisore nuk paraqet vetëm një term, nuk paraqet vetëm një fjalë, por paraqet problem universal, problem për të cilin njerëzimi nuk po bënë asgjë për ta ndaluar, dhe shkatërruar atë.

-Pse duhet me të patjetër të jem unë, të jem unë ajo që mbron apo nuk e dëmton mjedisin rreth saj?

-Kur të gjithë rreth nesh vazhdojnë pa ndal ta dëmtojnë atë, të jenë të pa përgjegjshëm?

-Ndryshimi asnjëher nuk ka filluar dhe asnjëher nuk do fillojë nga ata apo ato.

Ndryshimi fillon mu këtu tek unë dhe ju.

# EKOLOGJIA

Ekologjia është studim i marrëdhënieve midis organizmave të gjallë, duke përfshirë njerëzit dhe mjedisin e tyre, ajo kërkon të kuptojë lidhjet jetësore midis bimëve, kafshëve dhe botës përreth tyre...

Mjedisi është frymëzim për ne. Ndër më të rëndësishmet është ndjesia pozitive e cila vetvetiu shfaqet kur ne shohim një mjedis të pastër, nëse syri jonë sheh papastërti ne menjëherë do të kemi ndjenjen e zhgënjimit dhe demotivimit.

Arsyeja e krejt kësaj është se ne nuk po i japim mjedisit rëndësinë e mjaftueshme. Shpesh herë kemi dëgjuar për ekologjinë dhe temat e ndryshme sa i përkasin mjedisit, ka grupe të ndryshme të cilat bëjnë një punë të madhe sa i perketë vetëdijësimit për të pasur një jetë të shëndetshme dhe mjedis të pastër, por jo shumë herë kanë një rezultat të dukshëm.

Sa më shumë aktivitete për mjedisin tonë më mirë për ne. Ne si shoqëri duhet që të përdorim tokën në mënyra që të lëmë një mjedis të shëndetshëm për brezat e ardhshëm. Fatkeqësisht nëse ne e vrojtojmë oqeanin, janë aq të gjera saqë njerëzit i nënvlersojnë ndikimet dhe benifitet që ne kemi nga ujërat.

Njerëzimi në përgjithësi i ka marrë oqeanet si të pa rëndësishëm edhe pse oqeanet janë një furnizim i pa fund burimesh natyrore poashtu dhe një deponi e pafundme mbeturinash.





# EKOLOGJIA

Kemi qindra arsye pse duhet të shpëtojmë oqeanin dimë se mbi 70% e tokës mbulohet nga uji dhe kjo nënkupton se krijesat detare janë forma mbizotëruese të planetit tonë.

Përveç kësaj arsye tjetër është se fundi i oqeanëve na ofron naftë, gaz natyror, medikamente dhe përbërës për ushqime dhe produkte e të tjera. E mirë është kur ne marrim inicjativa për pastrimin e mjedisit duke filluar nga oborri i shtëpisë sonë, rrugët e vendit ku jetojmë dhe vendet e tjera, ku mund të bëhen organizime për gjelbërimin e ambienteve gjë e cila shkon për të mirën e qenieve të gjalla.

Por kur i mendojmë këto, ne shohim nivelin e ulët të vetëdijësimit që kemi, serioziteti është shumë i ulët në kuadër të këtyre aktiviteteve. Nëse analizojmë mjedisin ku jetojmë duhet të shfaqet ndjenja e shqetsimit për njerëzit. Gjë e cila duhet të na jap shtyerje për pastrimin e vendit tonë.

Aktivitetet e ndryshme, mos prerja dhe djegja e pyjeve, reciklimi i mbeturinave dhe mos hedhja e tyre vend e pa vend do të bëjë jetën tonë të shëndetshme dhe natyra do të na bëjë mikun më të ngushtë. Gjitha këto ne mundemi ti bëjmë dhe të jetojmë të shëndetshëm dhe të motivuar për të ardhmen tonë.

Motivimi ka të bëjë shumë se si ne e kemi mjedisin sepse absolutisht kjo ndikon në psikologjinë tonë e nder më e rëndësishmja është edhe se si ne fitojmë kulturen e pastërtisë së mjedisit.

Thuaj STOP gjerave të dëmshme për mjedisin.


**LUELA KRYEZIU DHE LEON HOXHAI – EKO KLUBI "LASGUSH  
PORADECI"**





# AKTIVITETET E EKO-KLUBIT:

TAKIMI MES EKO-KLUBIT DHE  
EC MA NDRYSHE





# **EKO KLUBI "LASGUSH PORADECI"** **KIJEVË, MALISHEVË**

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe  
Rr. Fehmi Lladrovci Nr.94, Prizren & Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7,  
Prishtinë

[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org)

[info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)

029 222 771 & 038 224 967

Ky buletin u realizua në kuadër të projektit "Ndikimi i Rinisë në Mjedis" - YENI, i cili bashkëfinancohet nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Caritas-i Zviceran, Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe implementohet nga OJQ EC Ma Ndryshe përmes projektit "ECO Schools".